



4. JAGUORINA

A/C

08.05.2017



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit - Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-
Ministry of Culture, Youth & Sports

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge
Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage
Prizren

DATË/A:	05.05.2017
REFERENC-Ë:	Nr. 65/4
PËR/ZA/TO:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Samir Hoxha - Drejtor i QRTK-së Prizren
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendimi i Komisionit të IKMM-së Prishtinë

Po ju dërgojmë Vendimin e Komisionit të IKMM-së për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese-Konservuese të Trashëgimisë Kulturorë nr.26/2017 të dt. 26.04.2017 për lëndën Besnik Xhara Nr.04-353-2137174 për mbindërtimin e objektit ekzistues në ngastrën kadastrale Nr. 3091-0.

Lëndës ia bashkangjesim kopjen e Vendimit.



INSTITUT I KOSOVËS PËR MBROJTJEN E MONUMENTEVE
INSTITUT KOSOVA ZA ZAŠTITU SPOMENIKA
211 04.05.2017

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve
Kosovo Institute for the Protection of Monuments
Institut Kosova za zaštitu spomenika

Nr. 26/2017
Datë: 26.04.2017

U.D. Drejtori i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve z. Agim Gërguri duke u mbështetur në nenin 3 (paragrafi, 4, 8), nenin 4 (paragrafët 14, 17, 19 dhe 20) nenin 6 (paragrafët 3, 4, 5, 7 dhe 8), nenin 12 (paragrafi 2) të Ligjit Nr. 02/L – 88 për Trashëgiminë Kulturore, si dhe në zbatim të vendimit Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit Nr. 18/2016 të datës 04.03.2016, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rekomandimi i Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve: “Miratimi i kërkesës/ projektit për mbindërtimin e objektit ekzistues në ngastrën kadastrale Nr. 3091 – 0 Z.K. Prizren, me pronar Besnik Xharra”.
2. Në bazë të rekomandimit të Komisionit, kërkohet që gjatë zbatimit, të respektohet projekti zbatues, i cili duhet të dorëzohet dhe miratohet në komision.
3. Zbatimi i punimeve sipas Projektit të aprovuar bëhet nën mbikëqyrjen e një eksperti nga Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Prizren.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Pala Besnik Xhara nga Prizreni, sipas procedurës së rregulltë, ka parashtruar kërkesën për mbindertimin e objektit ekzistues në ngastrën kadastrale me numër 3091 – 0. Etazhiteti i objektit ekzistues është B+P+1, ndërsa në pjesën e përparme të parcelës, është P+0. Objekti i lartëcekur, gjendet në zonën e III – të, sipas Planit të Konservimit ku etazhiteti i lejuar është P+2 dhe ku lartësia maksimale deri te streha është 9.5m si dhe, për ndërtim, mund të shfrytëzohet deri 80% e sipërfaqës së parcelës.

Në afërsi të parcelës për ndërtim, nuk ka ndonjë objekt që është në listën e MKRS “Lista e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme” (10.10.2016 – 10.10.2017). Objekti gjendet në rrugën “Rrasat e Kosharës” P.N.

Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, pas shqyrtimit të lëndës,

Rekomandon:

1. Aprovohet kërkesa e Besnik Xharës për mbindertimin e objektit ekzistues në ngastrën kadastrale me numër 3091-0, nën kushtin që:

- 1.1. Gardhi i ballkonit të jetë nga druri në harmoni me arkitekturën tradicionale.

2. Njoftohet pala se Projektin Kryesor, të Projektit Ideor të miratuar nga Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, duhet ta dorëzojë në QRTK – Prizren për verifikim (të gjitha kopjet e projektit që i nevojiten palës). Dy kopje dixhitale dhe dy kopje fizike të projektit kryesor mbeten në QRTK - Prizren (një për QRTK – në dhe një për IKMM – në).

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Projekteve IKMM;
- Departamentit të Trashëgimisë Kulturore;
- QRTK – së përkatëse;
- Komunës përkatëse;
- Departamentit Ligjor – MKRS;
- Zyrës së Drejtorit të IKMM –së;
- Arkivit të IKMM –së;
- Arkivit të MKRS – së;

Agim Gërguri

U.D. Director

